



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUSTEC
KËSHILLI BASHKIAK

Pustec, më 26.02.2026

• PROCESVERBAL

Lloji i mbledhjes: e rregullt

Vendi i mbledhjes: sala e mbledhjeve të Këshillit

Ora e fillimit: 12⁰⁰

Kryeson mbledhjen: kryetari i këshillit z.Naum Damo

Të pranishëm nga administrata janë: sp.NE znj.Marjeta Serbin, znj.Para Trajko , sp. projekteve dhe ndihmës së huaj znj.Klaudia Konopulli, përgj.sekt financës z.Cvetko Nasto

Këshilltarë të pranishëm në sallë janë: Naum Damo, Spase Tërpo, Vasilika Kolefski, Vaska Vasilovski, Taqo Grozdani, Jordan Jankulla, Jani Apostol, Nada Gjoli, Bllagica Mihal, Moza Simon, Sandi Nikolla

I pranishëm në mbledhje Kryetari i Bashkisë z.Pali Kolefski

Kryetari i këshillit: përshëndetje të gjithëve, fillojmë me kourumin e mbledhjes. Këshilltarë të pranishëm janë **njëmbëdhjetë**, kuorumi miratohet. Faleminderit!

Në mbështje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 52 “konflikt interesi” të gjithë këshilltarët që jemi të pranishëm duhet ta plotësojmë deklaratën e konfliktit të interesit.

Shënim: asnjë këshilltar nuk është në konflikt interesi me pikat e rendit të ditës

Faleminderit!

Vazhdojmë me shtjellimin e pikave të rendit të ditës

1.Për miratimin e rendit të ditës së mbledhjes

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 10 vota pro, 1 votë kundër. Faleminderit !

2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetari i këshillit: Pyetje ka? e kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 10 vota pro, 1 votë kundër. Faleminderit!

3. Për miratimin e bllok ndihmës ekonomike nga fondi 6% për muajin janar 2026

Sp.NE-përshëndetje, në bazë të verifikimeve të bëra nga grupi i kontrollit i ngritur nga ana e Bashkisë për verifikimin e familjeve të cilët kanë dalë jo përfituese nga skema e ndihmës ekonomike, të cilat do të trajtohen nga fondi i kushtezuar për bllok-ndihmen ekonomike deri në 6% rezulton për këtë muaj nuk kemi ndryshime.

Kryetari i këshillit: Pyetje ka? nëse jo e kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 10 vota pro dhe 1 votë kundër, 0 abstenim. Faleminderit!

4. Për disa ndryshime në VKB nr.5 datë 28.01.2026 "Për miratimin e Planit 5-vjeçar të Strehimit"

Sp.PAK - Vendimi i sipërcituar nuk u konfirmua nga Prefekti i Qarkut Korçë, në ushtrim të kontrollit të ligjshmërisë, për arsye se në Tabelën nr. 3 "Programi 5-vjeçar i Strehimit Social", konkretisht në pikën 23, ishte parashikuar si kategori përfituese: Familjet të cilave u janë dëmtuar banesat nga tërmeti i datës 21.09.2019 dhe tërmeti i datës 26.11.2019 dhe që nuk janë përfshirë në zonat e shpallura me VKM nr. 750, datë 27.11.2019. Sipas vlerësimit të Institucionit të Prefektit, kjo kategori nuk është e parashikuar në mënyrë të shprehur në nenin 16 të ligjit nr. 22/2018, datë 03.05.2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar, i cili përcakton në mënyrë taksative kategoritë përfituese të programeve të strehimit social. Si rrjedhojë është bërë rishikimi i dokumentit të programit.

Kryetari i këshillit: Pyetje ka? nëse jo e kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 10 vota pro, 1 votë kundër, 0 abstenim. Faleminderit!

5. Për miratimin e shpenzimeve faktike 2025

Kryetari i këshillit: Pyetje ka? nëse jo e kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 10 vota pro, 1 votë kundër, 0 abstenim. Faleminderit!

6. Për miratimin e të ardhurave të trashëguara nga viti 2025 për vitin 2026 të Bashkisë Pustec

Përgj. Finacës- shuma totale e të ardhurave të trashëguara për vitin 2026 është 77,130,461.03 lekë. I lexon me radhë të gjithë zërat e buxhetit të të ardhurave të trashëguara, sipas pasqyrës përkatëse. Këto fonde janë planifikuar të përdoren në përputhje me klasifikimin funksional dhe ekonomik të buxhetit, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve publike, përmbushjen e detyrimeve të mbartura dhe realizimin e investimeve prioritare për komunitetin.

Këshilltari Taqo Grozdan : Në buxhetin e të ardhurave të trashëguara po shikoj zërin për blerje mjete zjarri. Për çfarë bëhet fjalë?

Kryetari: Bëhet fjalë për mjetin që është blerë më parë. Mjeti është ende brenda periudhës së garancisë dhe duhet të kryhet pagesa përkatëse.

Këshilltari Jordan Jankulla : A është blerë si mjet i ri?

Kryetari: Jo, nuk është mjet i ri.

Këshilltari Taqo Grozdan : Çfarë përfaqëson shuma prej 500 000 lekësh e parashikuar për këshilltarët?

Përgj.financës : Kjo shumë lidhet me fondin e trashëguar ndër vite dhe parashikohet të përdoret për rritjen e pagave, e cila do të hyjë në fuqi nga data 1 janar. Në muajin e ardhshëm do të paraqiten edhe ndryshime në strukturën organizative.

Këshilltari Taqo Grozdan : A do të mbulohet rritja e pagave nga fondi i trashëguar?

Përgj.financës: Po, rritja e pagave do të financohet nga fondi i trashëguar.

Kryetari i këshillit: Pyetje ka? nëse jo i kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohen me 10 vota pro dhe 1 votë kundër, 0 abstenim. Faleminderit!

7.Detajimin e Fondit të Grantit të Bazuar në Përfomancën për Bashkitë për Vitin 2025 me Burim Financimi të Huaj

8.Detajimin e Fondit të Grantit të Bazuar në Përfomancën për Bashkitë për Vitin 2025 Burim Financimi nga Buxheti i Shtetit

Përgj.financës- Lidhur me dy projektvendimet për Detajimin e Fondit të Grantit të Bazuar në Performancën për Bashkitë për Vitin 2025, njëri me burim financimi të huaj dhe tjetri me burim financimi nga Buxheti i Shtetit, sqarojmë sa vijon: Të dy projektvendimet janë diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar të Këshillit. Fondet në fjalë janë akorduar nga Ministria e Financave dhe Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, në kuadër të Grantit të Bazuar në Performancë, si rezultat i përfundimit nga një program që vlerëson performancën e bashkive. Fondi i parë, me burim financimi të huaj, ka një vlerë totale prej 3,222,170.27 lekë. Fondi i dytë, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit, ka një vlerë prej 2,606,741.57 lekë. Të dy këto fonde do të përdoren për realizimin e projektit për rehabilitimin dhe strukturimin e rrugës në fshatin Kallamas.

Kryetari i këshillit: Pyetje ka? nëse jo i kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohen me 10 vota pro dhe 1 votë kundër, 0 abstenim. Faleminderit!

9.Mbi përcaktimin e një fondi për mbështetjen financiare të Grupit të Valleve të Bashkisë Pustec me honorar fiks mujor.

Përgj.financës- propozohet miratimi i shpërblimit për 12 anëtarët (valltarë dhe organizatorë) të grupit artistik, të angazhuar gjatë gjithë vitit në përgatitjen dhe realizimin e aktiviteteve kulturore dhe festive. Shpërblimi vlerësohet në 6,600 lekë në muaj për person, për një periudhë njëvjeçare. Ky shpërblim synon: motivimin e anëtarëve, sigurimin e vijimësisë dhe cilësisë së aktiviteteve, rritjen e profesionalizmit, promovimin e trashëgimisë kulturore dhe pjesëmarrjen e komunitetit. Pra është vazhdimësia e vendimit që kemi marrë vjet.

Këshilltari Moza Simon- jemi dakort për këtë që të promovohet zona në aktivitete të ndryshme.

Kryetari i këshillit: Pyetje ka? nëse jo i kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohen me 10 vota pro dhe 1 votë kundër, 0 abstenim. Faleminderit!

10.Pjesëmarrje në investime sipas projektit të fituar pranë Qarkut Korçë.

Kryetari: Ky është një projekt që kemi fituar nga Qarku i Korçës, me vlerë totale 8,000,000 lekë.

Këshilltari Taqo Grozdan : Si do të ndahet ky financim?

Kryetari: Ndarja bëhet si më poshtë:

- 60%, ose 4,800,000 lekë, do të sigurohen nga Qarku i Korçës;
- 40%, ose 3,200,000 lekë, do të mbulohen nga buxheti i bashkisë.

Këshilltari Taqo Grozdan : Për çfarë do të përdoren këto fonde?

Kryetari: Fondet do të përdoren për:

1. Blerjen e anijes turistike, dhe
2. Blerjen e autokombanjes lundruese për pastrimin e liqenit.

Kryetari i këshillit: Pyetje ka? nëse jo i kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohen me 10 vota pro dhe 1 votë kundër, 0 abstenim. Faleminderit!

11.Për shqyrtimin në Këshillin e Bashkisë Pustec të Planit Kombëtar të Kontigjencës për flukset e përziera migratore 2026–2028 dhe qëndrimin kundërshtues të Këshillit Bashkiak

Kryetari: Marrë shkas nga shqetësimi i këshilltarëve dhe i komunitetit për ardhjen e emigrantëve në rast emergjence, kemi përgatitur një projektvendim për të kundërshtuar VKM nr. 788, datë 24.12.2025, "Plani Kombëtar i Kontigjencës për flukset e përziera migratore 2026–2028". Ky plan parashikon ngritjen e tre qendrave pritëse në territorin e Bashkisë Pustec: në fshatin Zrnosko (Zaroshkë), në fushën sportive të Pustecit dhe në fushën sportive të Dollna Gorica (Goricë e

Vogël). Bashkia Pustec është e banuar kryesisht nga komuniteti maqedonas autokton, prandaj çdo vendim që ndryshon strukturën e banorëve duhet të analizohet me kujdes. Ngritja e këtyre qendrave nuk ka kaluar një proces konsultimi me pushtetin vendor dhe nuk ka analizë të plotë të ndikimit në mjedis, ndërsa fusha sportive dhe hapësirat publike do të përdoren për qëllime të tjera. Kjo mund të ndikojë negativisht në turizëm, në zhvillimin ekonomik dhe në jetën e komunitetit. Për këto arsye, propozohet që Këshilli i Bashkisë Pustec të marrë një qëndrim kundërshtues ndaj zbatimit të këtij vendimi në territorin e Bashkisë Pustec, në mbrojtje të interesave të komunitetit, të stabilitetit social dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të zonës

Kryetari i këshillit: Pyetje ka? nëse jo i kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohen me 11 vota pro, 0 vota kundër, 0 abstenim. Faleminderit!

Kryetari i këshillit: kalojmë dek diskutimet

○ Kërkesë për dhënien e ndihmës së menjëhershme

Kjo kërkesë është paraqitur nga zonja Anastasija Vasilovski, banore në fshatin Pustec, e cila është kryefamiljare e papunë dhe rrit dy djemtë e saj pas humbjes së bashkëshortit. Familja jeton vetëm me ndihmë ekonomike dhe përballat me vështirësi të mëdha financiare. Kërkesa lidhet me djalën e saj, Antonij Vasilovski, i cili ka filluar studimet universitare, por për shkak të mungesës së të ardhurave familjare rrezikon të ndërpresë studimet. Në kërkesë kërkohet mbështetje financiare nga Bashkia për të ndihmuar familjen dhe për t'i dhënë mundësi studentit të vazhdojë arsimin.

○ MFK

Nënkryetari i Bashkisë z.Atanas Pilloc-Të nderuar anëtarë të Këshillit, Tre dokumentet që paraqiten sot lidhen me funksionimin dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Bashkinë Pustec. Gjatë vitit 2025 ky sistem është zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar përdorimin e rregullt dhe transparent të fondeve publike, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të punës së sektorëve të bashkisë.

Raporti tregon se strukturat e bashkisë kanë ushtruar detyrat e tyre në sektorë të ndryshëm, duke ofruar shërbime për komunitetin dhe duke ndjekur realizimin e objektivave institucionale, ndërsa gjetjet dhe rekomandimet e auditimit janë marrë në konsideratë për përmirësimin e mëtejshëm të kontrollit të brendshëm.

Ndërkohë, plani i veprimit për vitin 2026 parashikon masa konkrete për përmirësimin e planifikimit të punës, menaxhimin e riskut, rritjen e transparencës dhe forcimin e procedurave administrative, me qëllim që administrimi i fondeve dhe shërbimeve të jetë edhe më efikas në të ardhmen.

○ Informacion nga sektori i bujqësisë

Gjatë mbledhjes u diskutuan disa problematika që lidhen me pronësinë e tokës bujqësore të përfutur sipas Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën". Një nga çështjet kryesore është procesi i lëshimit të certifikatave të pronësisë për familjet që kanë përfutur tokë sipas këtij ligji, por që ende nuk e kanë të regjistruar pronën në regjistrat kadastralë. Gjithashtu u ngrit si problem humbja e akteve të marrjes së tokës në pronësi (AMTP) nga ana e përfutuesve, gjë që vështirëson procesin e regjistrimit të pronës.

Një tjetër çështje e diskutuar lidhet me procedurat që duhet të ndiqen për kalimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme (tokës) në rastet kur kryefamiljari, në emër të të cilit është lëshuar AMTP-

ja, ka ndërruar jetë. Në këto raste është e nevojshme ndjekja e procedurave ligjore për çeljen e trashëgimisë dhe regjistrimin e pronës në emër të trashëgimtarëve ligjorë pranë institucioneve përkatëse. U theksua nevoja për informimin e qytetarëve mbi procedurat dhe dokumentacionin që duhet të ndjekin për zgjidhjen e këtyre çështjeve.

MIRATUAN
Sekretar i këshillit

Todora TERPO



Kryetar i këshilli

Naum DAMO

